



Vq

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE**  
**DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Adresa: Rr. Reshit Çollaku. Tel: 0800 9999. Website: [www.hidaa.gov.al](http://www.hidaa.gov.al). E-mail: [info@hidaa.gov.al](mailto:info@hidaa.gov.al)

Nr. Indeksi  
në ILDKPKI-  
dhe Viti

2018

**DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATE**  
**PERIODIK / VJETOR**

Plotësohet nga subjekti deklarues (zyrtari) që mbart detyrimin për deklarim të interesave private të tij, të bashkëshortit/esh bashkëjetuesit/esh dhe të fëmijëve madhorë, në bazë të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", me ndryshimet e pasqyruara në Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, Ligjin nr. 9475, datë 9.2.2006, Ligjin nr. 9529, datë 11.5.2006, Ligjin nr. 85/2012, datë 18.9.2012, Ligjin nr. 45/2014, datë 24.4.2014 dhe Ligjin nr. 42/2017, datë 6.4.2017.

**A U T O R I Z I M**  
**PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATE**

<b>Emri</b>	<b>Atësia</b>	<b>Mbiemri</b>
KRESHNIK	GËZIM	AJAZI
<b>Funksioni</b>		
PROKUROR		
<b>Institucioni dhe adresa</b>		
Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, Lagjia Nr.3, Rruga "Andon Xoxi" (caktim i përkohshëm 01 Janar – 19 Janar/2018).		
Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Lagjia "5 Maji", Rr. "Ismail dhe Xhemali Debrova" (19 janar – 30 maj/2018).		
Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Rr. "Haxhi Hysen Dalliu" (caktim i përkohshëm 30 Maj – 31 dhjetor/2018).		
<b>Data e emërimit në funksionin që kryen</b>		<b>Data e dorëzimit të deklaratës</b>
12.10.2009 prokuror në stazh 02.11.2010 prokuror		25-03-2019

Në bazë të nenit 9/1, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar,

**A u t o r i z o j:**

Inspektoratit e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës -Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

**Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.**

**Nënshkrimi i subjektit deklarues**

KRESHNIK AJAZI

## NDRYSHIMET E PASURIVE DHE BURIMI I KRIJIMIT

**Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesa dhe pakësime) në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve vlerën që keni shtuar apo pakësuar, pjesën takuese që zotëroni të çdo lloj pasurie\*, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit.**

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %
1.	Shtesë në kursimet personale të mbajtura <i>cash</i> jashtë sistemit bankar. Burimi kanë qënë të ardhurat specifikuar më poshtë. Kjo shumë i shtohet atyre totale të deklaruara në deklaratën pararendëse. Në total gjendja <i>cash</i> është 1.075.000 (një milion dhe shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë.	75.000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë	100%
2.	Shtesë në llogarinë e depozitës në bankën " " Lloji depozitë pa afat. Monedha "Euro". Çelur më datë 24.10.2016. Norma e interesit me bazë vjetore 0.05%. Vlera fillestare e krijimit të llogarisë 17.500 euro. Shtesa ka ardhur si rrjedhojë e normës së interesit. Kjo llogari depozite më datë 19.06.2018 është pakësuar në shumën 5.000 (pesë mijë) euro për shkak të tërheqjes që kam bërë. Kjo llogari depozite më datë 20.07.2018 është pakësuar në shumën 2.500 (dy mijë dhe pesëqind) euro për shkak të tërheqjes që kam bërë. Më datë 17.12.2018 kjo llogari është shtuar në shumën 4.500 (katër mijë dhe pesëqind) euro pasi kam kryer rikthimin e një pjesë të shumës së tërhequr më sipër dhe konkretisht 2.000 euro nga tërheqja e datës 19.06.2018 dhe 2.500 euro nga tërheqja e datës 20.07.2018. Gjendja e llogarisë më datë 31.12.2018 është 14.514,13 (katërmëdhjetë mijë dhe pesëqind e katërmëdhjetë presje trembëdhjetë) euro. Shtimi vjetor i llogarisë për shkak të normës së interesit kreditor është 5.39 (pesë pikë tridhjetë e nëntë) euro. Bashkëlidhur dy fletë mandat tërheqje dt.19.06.2018 dhe dt.20.07.2018 si dhe një fletë dt.20.03.2019 statement për gjendjen e llogarisë më datë 31.12.2018.	5.39 (pesë pikë tridhjetë e nëntë) euro shtesa për shkak të interesave kreditore pas mbajtjes së tatimit mbi fitimin.	100 %
3.	Llogari rrjedhëse në bankën " " Monedha "Lek". Bashkëlidhur shtatë fletë statement dt.20.03.2019 i nxjerrjes së llogarisë për periudhën 01.01.2018-31.12.2018. Në këtë llogari janë kryer veprime kreditim/tërheqje page. Bashkëlidhur shtatë fletë statement bankar.	Gjendja e llogarisë më datë 31.12.2018 është 1.012.89 (një mijë e dymbëdhjetë presje tetëdhjetë e nëntë lekë) lekë.	100%
4.	Llogari rrjedhëse në bankën " " Monedha "Lek". Bashkëlidhur dy fletë statement dt.20.03.2019 i nxjerrjes së llogarisë për periudhën 01.01.2018-31.12.2018. Gjatë vitit 2018 në këtë llogari janë kryer veprimet e kreditimit të honorareve nga universiteti dhe shkolla e magistraturës (dekluar më poshtë) dhe debitimet (tërheqjet e parave, komisionet dhe interesat bankare). Bashkëlidhur një fletë e printuar nga sistemi online i bankës ku rezultojnë tërheqjet nga ATM më datë 30 dhe 31 dhjetor 2018 si dhe faturë ATM për tërheqje parash dt.30.12.2018.	Gjendja reale e llogarisë më datë 31.12.2018 është 1.854,41 (një mijë dhe tetëqind e pesëdhjetë e katër presje dyzet e një) lekë. Në statement gjendja dt.31.12.2018 rezulton 76.854,41 (shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e katër presje dyzet e një lek) por në fakt ky është gabim i sistemit bankar pasi më datë 30 dhe 31 dhjetor kam tërhequr nga ATM shumat prej 25.000 lekë dhe 50.000 lekë pra në total shumën 75.000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë.	100%
5.	Llogari rrjedhëse në " " Monedha "Lek". Nr.Klienti " " Kjo llogari është hapur më datë 07.05.1997 në emrin tim nga nëna ime, si depozitë interesi me nr.depozite " " e ish zyrën bankare të " " Gramsh. Mbartur " " Vlera fillestare e çeljes së llogarisë ka qënë 10.000 (dhjetë mijë) lekë. Bashkëlidhur dy fletë kopje e librezës viti 1997.	Gjendja është rreth 15.980 (pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë.	100%

\* **Objekti i deklarimit** (Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar)

a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil,

b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil,

c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 lekë;

d) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;

d) vlerën e likuiditeve, gjendje në Cash, jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj.

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues**

KRESHNIK AJAZI *K. Ajazi*


**TË ARDHURAT DHE ANGAZHIMET  
NË VEPRIMTARI  
PUBLIKE DHE/OSE PRIVATE**

Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie e kryer brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, liçensa dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; për periudhën nga data e deklarimit të mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit.

**Përshkruani hollësisht të ardhurat brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione e çdo angazhim e veprimtari tjetër që ka sjellë të ardhura për subjektin, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en dhe fëmijët madhorë. Përcaktoni emërtimin e institucionit, organizatës apo aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrimit publik, statusi, objektin e veprimtarisë së organizatës, funksionin, natyrën e angazhimit, nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 Dhjetor të vitit të deklarimit.**

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave <u>neto</u> të krijuara, në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë)
Të ardhura (paga-shtesa-shërbime gadishmërie) nga detyra si prokuror në periudhën 01.01.2018-31.12.2018. Paga është tërhequr në llogarinë rrjedhëse në bankën [redacted] Bashkalidhur një fletë vërtetim [redacted] datë 13.03.2019 i Drejtuesit të Prokurorisë Elbasan. Pagesat për detyrën dhe shërbimin e gadishmërisë në Prokuroritë e Pogradecit dhe Tiranës ku kam qënë i caktuar përkohësisht janë paguar nga Prokuroria e Elbasanit sepse në të kam emërimin.	1.216.784 lekë (një milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër).
Pagesa honorare nga mësimdhënia si lektor i jashtëm në Universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, Fakulteti Ekonomik. Bashkëlidhur një fletë mbi të ardhurat personale [redacted] dt.18.03.2019 e Rektoratit të UAXH. Detajisht të dhënat për pagesat i gjeni tek statementi bankar i llogarisë në bankën [redacted] (bashkalidhur).	59.635 lekë (pesëdhjetë e nëntë mijë dhe gjashtëqind e tridhjetë e pesë lekë).
Pagesë honorare nga veprimtaria si lehtësues nga Shkolla e Magjistraturës Tiranë për programin e trajnimit vazhdues për gjyqtarë dhe prokurorë. Bashkëlidhur një fletë vërtetim [redacted], dt.21.03.2019 e Shkollës së Magjistraturës. Detajisht të dhënat për pagesat i gjeni tek statementi bankar i llogarisë në bankën [redacted] bashkalidhur).	48.269 lekë (dyzet e tetë mijë dhe dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë lekë).
Pagesë (dieta) nga Këshilli Europës për vizitën studimore në Strasbourg në prill 2018. Pagesa është realizuar me anë të çekut, i cili është shkëmbyer me para në bankë në godinën e KE në Strasbourg. Bashkëlidhur çeku [redacted] dt.18.04.2018.	236,25 euro (dyqind e tridhjetë e gjashtë presje njëzet e pesë).
Pagesë (dieta dhe rimbursim shpenzimesh) nga qeveria e Britanisë së Madhe dhe International Senior Lawyers Project ISLP, për vizitën studimore në Londër në shkurt 2018. Pagesa është realizuar cash.	355 (treqind e pesëdhjetë e pesë) GBP (paund).

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues**

**KRESHNIK AJAZI** 

*Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.*

**DETYRIMET FINANCIARE  
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË**

Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit, si dhe detyrimet e lindura për subjektin gjatë vitit të deklarimit.

Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve subjekti deklarues ka detyrime financiare, të pasqyrohen në faqen nr. 7, për të ruajtur konfidencialitetin e tyre.

**Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë. Për kreditë bankare shumën e kredisë (principal), kohëzgjatjen (muaji/viti) dhe kësti mujor.**

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit (me shifra dhe fjalë)	Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit (me shifra dhe fjalë)
Hua e marrë nga [ ] ku marr rrogën, në formën e overdraftit në monedhë "lek". Marrëveshja e lidhur më datë 29.10.2012, ripërtëritë më datë 18.11.2014 me kontratën [ ] më datë 23.11.2015 me kontratën [ ] më datë 27.11.2017 me kontratën [ ] Shuma e huasë 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Afati 1 vjeçar dhe norma e interesit 16 % në vit. Kontrata lidhet me kartën e kreditit visa elektron classic. Kjo llogari është përdorur dhe çdo shpenzim është mbuluar me urdhër xhirim të brendshëm ose derdhje cash me të ardhura nga paga. Bashkëlidhur dy fletë statement printuar nga sistemi bankar i [ ] dt.20.03.2019. ku pasqyrohet edhe gjendja e kartës më dt.31.12.2018.	Shuma totale e detyrimit për vitin 2018 prej 52.000 (pesëdhjetë e dy mijë) lekë të përdorura gjatë vitit së bashku me detyrimet kartës (komision dhe interesa) është shlyer sipas derdhjes cash më datë 17.12.2018, ku burim për shlyerjen ka qënë të ardhurat e pagës që janë tërhequr cash nga llogaria e pagës më dt.17.12.2018.	-----

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues**

**KRESHNIK AJAZI** *K. Ajazi*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE  
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Adresa: Rr.Reshit Çollaku, Tel: 0800 9999, Ëebsite: [www.hidaa.gov.al](http://www.hidaa.gov.al), E-mail: [info@hidaa.gov.al](mailto:info@hidaa.gov.al)

Nr. Indeksi  
në ILDKPKI

DEKLARATË E INTERESAVE PRIVATE  
E PERSONIT TË LIDHUR

Plotësohet dhe nënshkruhet nga personi i lidhur me subjektin deklarues (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë) që mbartin detyrimin për deklarim në bazë të nenit 22 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, për pasuritë që disponohen veçmas.

A U T O R I Z I M  
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATE

Në bazë të nenit 9/1, të Ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar,

**Autorizoj:**

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës - Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time.

Shtetasi/ja \_\_\_\_\_, bashkëshorti/ja   
Emër, Atësi, Mbiemër fëmijë madhorë së bashku me prindërit   
fëmijë madhorë të ndarë nga prindërit   
bashkëjetuesi/ja

i/e Subjektit \_\_\_\_\_  
Emër, Atësi, Mbiemër

Jam njohur me detyrimet që sanksionon legjislacioni në fuqi dhe deklaroj nën përgjegjësinë time ligjore se:

Disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim   
Nuk disponoj pasuri veçmas të regjistruar në emrin tim

*Deklaroj se të dhënat e pasqyruara prej meje në këtë dokument janë të vërteta dhe nuk kam deklaruar asgjë që nuk është e vërtetë.*

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur

\_\_\_\_\_

**NDRYSHIMET E PASURIVE  
DHE BURIMI I KRIJIMIT**

**Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesa dhe pakësime) në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve vlerën që keni shtuar apo pakësuar, pjesën takuese që zotëroni, të çdo lloj pasurie\*, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të viti të deklarimit.**

Nr.	Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit	Vlera me shifra dhe me fjalë	Pjesa në %

**\*Objekti i deklarimit** (Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i Ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar)

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë, dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi **300 000 lekë**;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në **Cash** jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

*Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.*

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur**

**TË ARDHURAT DHE ANGAZHIMET NË  
VEPRIMTARI PUBLIKE DHE/OSE PRIVATE**

Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie e kryer brenda ose jashtë territorit të Shqipërisë, që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, liçensa dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër; për periudhën nga data e deklarimit të mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit.

**Përshkruani hollësisht të ardhurat për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione e çdo angazhim e veprimtari tjetër që ka sjellë të ardhura personale, për bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en dhe fëmijët madhorë. Përcaktoni emërtimin e institucionit, organizatës apo aktivitetit nga ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrimit publik, statusi, objektin e veprimtarisë së organizatës, funksionin, natyrën e angazhimit, nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 Dhjetor të vitit të deklarimit.**

Përshkrimi i të ardhurave	Shuma e të ardhurave <u>neto</u> të krijuara, në lekë apo në valutë (me shifra dhe me fjalë)

**DETYRIMET FINANCIARE  
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË**

- Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit, si dhe detyrimet e lindura gjatë vitit të deklarimit.
- Të dhënat për emra personash ndaj të cilëve personi i lidhur ka detyrime financiare, të pasqyrohen në faqen nr.11 për të ruajtur konfidencialitetin e tyre.

**Përshkruani hollësisht qëllimin e detyrimit financiar, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin bazë. Për kreditë bankare shumën e kredisë (principal), kohëzgjatjen (muaji/viti) dhe kësti mujor.**

Përshkrimi i detyrimeve	Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit (me shifra dhe fjalë)	Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit (me shifra dhe fjalë)

*Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.*

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i personit të lidhur**

## Informacion në ndihmën tuaj:

Detyrimi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, interesave private, detyrimeve financiare të zyrtarëve dhe personave të lidhur me ta, sanksionohet në ligjet mbi të cilat ushtron veprimtarinë Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave:

- Ligj nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar
- Ligj nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.

### Deklarimi i interesave private nga zyrtari (subjekti deklarues)

- Dokumenti zyrtar “Deklaratë e interesave private priodik/vjetor” duhet të plotësohet nga zyrtari në funksion, por edhe në rastet kur zyrtari ka patur ndërprerje për më pak se një vit nga funksioni i mëparshëm (nga deklarimi i tij i fundit).
- Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es, bashkëjetuesi/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit.
- Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes, me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim.
- Formulari i deklarimit plotësohet vetëm në mënyrë elektronike (me kompjuter). Pas printimit të formularit të plotësuar sipas kërkesave ligjore, bëhet nënshkrimi për çdo fletë të tij, sipas rubrikave përkatëse.
- Subjekti/zyrtari nuk legjitimohet të nënshkruajë deklaratën e interesave private të personave të lidhur.
- Deklarata duhet të plotësohet dhe dorëzohet, deri më 31 Mars të çdo viti.

### Deklarimi i interesave private nga personi i lidhur me zyrtarin (subjektin deklarues)

- Dokumenti zyrtar “Deklaratë e interesave private e personit të lidhur” duhet të plotësohet nga personat e lidhur (bashkëshortit/ja, bashkëjetuesit/ja dhe fëmijët në moshë madhore) që mbartin detyrimin për deklarim në bazë të nenit 21 dhe 22 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, **për pasuritë që disponojnë veçmas.**
- Subjekti/Personi i lidhur me zyrtarin, (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore), i cili mbart detyrimin për deklarim të interesave private në Inspektoratin e Lartë, plotëson formularin përkatës nga faqja 8-11.
- Në çdo rast, subjekti deklarues personi i lidhur, është i detyruar të plotësojë faqen e parë të deklaratës “AUTORIZIMI” ku deklarohet nëse ka ose jo pasuri të regjistruara në emrin e tij. Formulari i plotë do të plotësohet vetëm në rastet kur personi i lidhur ka pasuri të regjistruar veçmas.

### Sanksionet:

- Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas nenit 40 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.
- Për mosdeklarim para fillimit të detyrës, periodik vjetor, pas largimit nga funksioni apo me kërkesë, në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, zyrtari ose personi i lidhur me të, që mbart detyrimin për deklarim, dënohet me gjobë nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.
- Refuzimi për deklarim nga zyrtari, sjell humbjen e funksionit dhe ndëshkimin në përputhje me nenin 257/a të Kodit Penal.
- Refuzimi për deklarim nga personi i lidhur dënohet me gjobë dhe ndëshkohet sipas nenit 257/a të Kodit Penal
- Deklarimi i rremë apo fshehja e pasurisë përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

***Kujdes: Të gjitha faqet e formularit të deklaratës duhet të nënshkruhen, në të kundërt deklarata do të kthehet dhe do të konsiderohet e padorëzuar në Inspektoratin e Lartë.***

- Për informacione të mëtejshme, kontaktoni në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave me Seksionin e Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse në numrat e telefonit **042 259 461** Free.08009999, [info@hidaa.gov.al](mailto:info@hidaa.gov.al).
- Të dhënat e deklaratës lejohet të publikohen sipas ligjit.